



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.715/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesuese, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelet e Flakadan Banushi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHEN** si të pabazuara apelet e parashtruara nga Flakadan Banushi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me shenjën ZL.Anr.715/2017, ZL.Anr.717/2017, ZL.Anr.718/2017, ZL.Anr.719/2017, ZL.Anr.720/2017, ZL.Anr.721 dhe ZL.Anr.722 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

## A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, ka pranuar apelet ZL.Anr.715/2017, ZL.Anr.717/2017, ZL.Anr.718/2017, ZL.Anr.719/2017, ZL.Anr.720/2017, ZL.Anr.721 dhe ZL.Anr.722 me datën 09.11.2017, nga parashtruesi i apeleve Flakadan Banushi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan nga radha e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega Lipjan. Në ankesat e parashtruara nga ankuesi pretendohet se në vendvotimet: 1315E, 1303E, 1328E,1323E, 1310E,1310E, 13101x,1331E në Lipjan, Janjev, Ribari i Bardhë, Rufci i Ri, Konjan dhe Topliqan të komunës së Lipjanit, me të cilën pretendon se ka pasur keqpërdorime gjatë numërimit, ashtu që nga komisionarët e vendvotimeve iu janë vjedhur votat e tij.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.715/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për shtatë apelet që përmbajnë në vete çështje të

ngjashme , dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apelet janë të pabazuara**

Paneli i PZAP-it, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit gjeti se apelet me asnjë provë bindëse nuk janë dëshmuar pretendimet ankimore dhe nuk i ka specifikuar se sa vota dyshon që i mungojnë për qendrat e votimit me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi dhe keqpërdorime të votave. Prandaj Paneli ankesat e ankuesit i konsideron si të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesa, konstaton se ankesat në fjalë janë të pabazuara dhe e të pa argumentuara dhe si të tilla ankesat e ankuesit i refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.715/2017 më datën 11.11.2017.

**Kryesuesja e Panelit**  
**Rafet Haxhaj**



### ***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*